



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr.29**

**2005**

**3 maj**

### P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9362 datë 24.3.2005	Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve .....	1095
Ligj nr.9363 datë 24.3.2005	Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit.....	1102
Ligj nr.9364 datë 31.3.2005	Për ratifikimin e “Konventës “Për pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike, në nivel lokal”” .....	1110
Ligj nr.9365 datë 31.3.2005	Për procedurat e njohjes së zotësisë juridike të personave juridikë kishtarë të Kishës Katolike.....	1115
Vendim i GJK nr.6, datë 15.4.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.3357, datë 16.11.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1216, datë 13.12.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.467, datë 24.4.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	1117

Vendim i GJK nr.7, datë 27.4.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.210, datë 11.9.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr.194, datë 21.10.2003 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.206, datë 23.4.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	1121
Rregullore e ISSH nr.35/1, datë 30.3.2005	Për disa shtesa e ndryshime në rregulloren nr.35, datë 19.6.2002 “Për sigurimin vullnetar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore”...	1125
	Shpallje kërkesë për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore” që preken nga ndërtimi i nënstacionit elektrik 110/20 kV Burdullias-Berat.....	1127

**LIGJ**  
**Nr. 9362, datë 24.3.2005**

**PËR SHËRBIMIN E MBROJTJES SË BIMËVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të mbrojë bimët dhe produktet bimore nga parazitët;
- b) të parandalojë hyrjen dhe përhapjen e parazitëve në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) të mbrojë shëndetin e njerëzve, të kafshëve, si dhe mjedisin nga përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- ç) të garantojë zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së bimëve.

Neni 2  
**Përkufizime**

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

1. “Inspektor” është inspektori i mbrojtjes së bimëve dhe karantinës.
2. “Parazit” është dëmtuesi, sëmundja dhe barërat e këqija, të dëmshme ose potencialisht të dëmshme për bimët dhe produktet bimore.
3. “Parazit karantinor” është një parazit i rrezikshëm, me ndikim të rëndësishëm ekonomik, që nuk është vërejtur ose është vërejtur në vendin tonë, por nuk është i përhapur gjerësisht.
4. “Produkt për mbrojtjen e bimëve (PMB)” është çdo produkt që përmban një ose më shumë lëndë vepruese, i cili përdoret:
  - a) për mbrojtjen e bimëve dhe të produkteve bimore nga parazitët ose për parandalimin e veprimit të tyre;
  - b) për të ndikuar në proceset jetësore të bimëve, por me veprim të ndryshëm nga plehërat kimike (për shembull, rregullatorët e rritjes);
  - c) për të shkatërruar bimët e padëshirueshme, pjesët bimore, si dhe për të mbajtur nën kontroll ose për të parandaluar rritjen e pjesëve bimore të padëshirueshme.
5. “Regjistrim” është miratimi për tregtim dhe përdorim të një PMB-je nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, bazuar në procedurën e vlerësimit të të dhënave shkencore të plota, të cilat vërtetojnë se PMB-ja është efektive për qëllimet e përdorimit dhe nuk përbën rrezik për njerëzit, kafshët dhe mjedisin.
6. “Zonë” është territori ose pjesë e territorit që i përket një apo më shumë fshatrave, komunave, bashkive ose qarqeve.
7. “Mbetje të PMB-së” janë një ose më shumë lëndë vepruese të pranishme në bimë, në produkte me origjinë bimore, në produkte të ngrënëshme me origjinë shtazore, në mjedis, si rrjedhojë e përdorimit të PMB-së, duke përfshirë këtu edhe metabolitet dhe produktet që dalin nga shpërbërjet e tyre.

8. “Mbrojtje e bimëve” është mbrojtja e bimëve nga dëmtimet që shkaktohen prej parazitëve.

9. “Mbrojtje e integruar” është përdorimi i kombinuar dhe i arsyeshëm i masave biologjike, bioteknologjike, kimike dhe teknikave të kultivimit, të cilat kufizojnë përdorimin e PMB-së në minimumin e nevojshëm, për të mbajtur popullatat e parazitëve në atë nivel, ku dëmi ekonomik është i pranueshëm.

10. “Certifikim i materialit shumëzues” është një procedurë ku bimët mëmë, kandidatë për dhënie të materialit shumëzues, kalojnë nëpër analiza dhe, kur është e nevojshme, në trajtim të veçantë, për të siguruar pastërtinë nga viruset dhe organizmat e tjerë të ngjashëm me ta.

11. “Praktika të mira të mbrojtjes së bimëve” është tërësia e masave për luftimin e parazitëve me metodat kimike, duke respektuar kushtet në të cilat PMB-të janë regjistruar, si: respektimi i kufijve kritikë, zgjedhja e dozës dhe volumit, koha dhe numri i trajtimeve, mbrojtja e entomofaunës natyrore dhe e mjedisit, si dhe kujdesi për shëndetin e përdoruesve dhe konsumatorëve.

12. “Objekte të tjera” janë çdo vend ruajtje, mjet transporti, konteiner, tokë, organizma të gjallë etj., që shërbejnë për strehimin ose përhapjen e parazitëve.

13. “Bimë” janë bimë të gjalla ose pjesë të tyre të gjalla, përfshirë farërat dhe germoplazmën.

14. “Prekje ose infeksion” është prania e parazitëve të gjallë në bimë, në produkte bimore dhe në objekte të tjera.

15. “Inspektim” është shqyrtimi pamor i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera, i kryer nga inspektori, për të përcaktuar nëse ato janë të infektuar ose të prekur me parazitë dhe nëse ato janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

16. “Karantinë bimore” është tërësia e masave parandaluese për hyrjen dhe/ose përhapjen e një paraziti karantinor.

17. “Produkt bimor” është material me origjinë bimore, i përpunuar ose jo, i cili mund të përbëjë rrezik për hyrjen dhe përhapjen e parazitëve dhe parazitëve karantinorë.

18. “Trajtim” është procedurë e autorizuar për ngordhjen, largimin ose bërjen të pashumëzueshëm të parazitëve.

19. “Certifikatë fitosanitare” është një dokument zyrtar i lëshuar nga Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve, i cili tregon se kushtet fitosanitare të bimëve, të produkteve bimore dhe të objekteve të tjera plotësojnë standardet e përcaktuara nga vendi importues.

20. “Masa të veçanta luftimi” është një tërësi masash karantinore, kimike agroteknike etj., që ndërmerren në rastet e shtimit dhe përhapjes masive të parazitëve dhe që synojnë në uljen e infeksionit nën nivelin e dëmit ekonomik ose në çrrënjosjen e plotë të tyre.

## KREU II

### ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES SË BIMËVE

#### Neni 3

#### **Drejtimi dhe përbërja e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve**

Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve drejtohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit dhe përbëhet nga:

- a) Drejtoria e Mbrojtjes së Bimëve;
- b) Instituti i Mbrojtjes së Bimëve.

#### Neni 4

#### **Drejtorja e Mbrojtjes së Bimëve**

1. Drejtoria e Mbrojtjes së Bimëve është autoriteti kompetent që harton politikën e mbrojtjes së bimëve, si dhe organizon dhe ndjek zbatimin praktik e shkencor të këtij shërbimi nëpërmjet:

a) Inspektoratit të Mbrojtjes së Bimëve dhe të Karantinës në nivel qendror (Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit) dhe rajonal (qarku), i cili kontrollon zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, që rrjedhin prej tij;

b) Sekretarisë (Zyrës) së Regjistrimit të PMB-ve dhe Certifikimit të Materialit Shumëzues, e cila merret me procedurën e regjistrimit të PMB-ve, si dhe me procedurën e certifikimit të materialit shumëzues të specieve që shtohen në mënyrë vegjetative;

c) Komisionit Shtetëror të Regjistrimit të PMB-ve (KSHRPMB), si organ kolegjal teknik, i cili funksionon në mënyrë periodike në procedurën e regjistrimit të PMB-ve;

ç) laboratorëve rajonalë (të qarkut) të mbrojtjes së bimëve, të cilët merren me diagnostikimin dhe monitorimin e parazitëve dhe të parazitëve karantinorë, duke përcaktuar edhe masat e luftimit të tyre.

2. Drejtori i Drejtorisë së Mbrojtjes së Bimëve është njëkohësisht kryeinspektor i këtij shërbimi.

#### Neni 5

### **Instituti i Mbrojtjes së Bimëve**

Instituti i Mbrojtjes së Bimëve është institucioni kërkimor shkencor dhe referencë kombëtare në zbatimin e këtij ligji, i cili ka për detyrë:

a) të monitorojë parazitët karantinorë, të përcaktojë statusin e tyre, metodat e kontrollit karantinor dhe të njoftojë Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit;

b) të bëjë kontrollin cilësor të PMB-ve dhe të mbetjeve të tyre në bimë, në produkte bimore, në ujë dhe në tokë;

c) të bëjë diagnostikimin dhe prognozë-sinjalizimin e parazitëve, duke përcaktuar edhe masat e luftimit të tyre;

ç) të bëjë provat biologjiko-agronomike, si dhe analizat fiziko-kimike të PMB-ve për regjistrimin e tyre.

#### Neni 6

### **Bashkëpunimi**

Drejtorja e Mbrojtjes së Bimëve bashkëpunon dhe koordinon punën me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit për përshtatjen e standardeve ndërkombëtare në Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve.

#### Neni 7

### **Bazueshmëria ligjore e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve**

Organizimi dhe veprimtaria e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve rregullohet me këtë ligj, si dhe me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

### **KREU III**

### **LUFTIMI I PARAZITËVE**

#### Neni 8

### **Masat paraprake të luftimit të parazitëve**

Personat fizikë dhe juridikë që kultivojnë, prodhojnë, magazinojnë, përpunojnë dhe tregtojnë bimë dhe produkte bimore, janë të detyruar:

a) të marrin masa paraprake kundër parazitëve, si dhe të parandalojnë shumëzimin dhe përhapjen e tyre;

b) të vrojtojnë bimësinë, tokën dhe produktet bimore për shfaqjen e parazitëve dhe t'i luftojnë ato në bazë të praktikave të mira të mbrojtjes së bimëve dhe të kriterëve të mbrojtjes së integruar.

#### Neni 9

##### **Fondet e veçanta për mbrojtjen e bimëve**

1. Në buxhetin vjetor që miratohet për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit planifikohen fonde të veçanta për mbrojtjen nga parazitët të bimëve të kultivuara apo spontane.

2. Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit nxjerr urdhër për mbrojtjen nga parazitët, luftimi i të cilëve përballohet me këto fonde.

#### Neni 10

##### **Masat e veçanta të luftimit të parazitëve**

1. Në rastet emergjente të përhapjes dhe shtimit masiv të parazitëve, të cilët nuk mund të kufizohen me metodat e zakonshme të luftimit, Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit me urdhër përcakton masa të veçanta për luftimin e tyre, duke mobilizuar për këtë qëllim subjektet shtetërore dhe private, të cilët zotërojnë kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe materiale.

2. Shpenzimet e luftimit në këto raste përballohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

#### Neni 11

##### **Pastërtia e materialit shumëzues dhe mbjellës**

1. Materialet bimore për shumëzim ose mbjellje lejohet të përdoren vetëm pasi t'i jenë nënshtruar inspektimit fitosanitar dhe të jenë pajisur me certifikatë fitosanitare.

2. Speciet drufrutore dhe hardhia, të cilat shtohen në mënyrë vegjetative, i nënshtrohen procedurës së certifikimit të materialit shumëzues për të siguruar pastërtinë nga viruset dhe organizma të tjerë të ngjashëm me to.

#### Neni 12

##### **Udhëzime të Ministrit**

Rregullat për luftimin e parazitëve përcaktohen me udhëzime të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

#### KREU IV

##### **INSPEKTIMI KARANTINOR FITOSANITAR**

#### Neni 13

##### **Detyrimi për inspektim karantinor fitosanitar**

Importi, eksporti dhe kalimi tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera bëhet në pikat doganore të hyrjes, ku funksionon inspektimi karantinor fitosanitar dhe i nënshtrohen këtij inspektimi.

#### Neni 14

##### **Veprimtari të ndaluara**

Ndalohet:

1. Importi, eksporti dhe kalimi tranzit i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera të infektuara me parazitë karantinorë.

2. Importi, eksporti dhe kalimi tranzit i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera, nëse ato nuk janë të pajisura me certifikatë fitosanitare.

3. Shumëzimi dhe kultivimi i bimëve të infektuara me parazitë karantinorë.

#### Neni 15

### **Bashkëpunimi për inspektimin karantinor fitosanitar**

Për zbatimin e këtij ligji inspektori bashkëpunon, sipas marrëveshjeve të nënshkruara, me policinë kufitare, me punonjësit e doganës, me agjencitë rrugore, detare dhe hekurudhore, me kapiteneritë e porteve detare, me Inspektoratin Sanitar Shtetëror dhe me Inspektoratin Veterinar.

Ai është pjesë e grupit të praktikës doganore, që merr kontaktin e parë me mjetet që transportojnë bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera.

#### Neni 16

### **Njoftimi i organeve të Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve**

Personat fizikë dhe juridikë, që merren me kultivimin, prodhimin dhe magazinimin e bimëve dhe të produkteve bimore, kur vërejnë ose dyshojnë për një parazit të pahasur më parë në një zonë ose për shtim masiv të një paraziti, janë të detyruar të njoftojnë menjëherë organet e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve, si dhe të sigurojnë një mostër të tij.

#### Neni 17

### **Shpallja e zonës së prekur**

Kur në një zonë shfaqet një parazit karantinor, Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit e shpall me urdhër këtë zonë të prekur dhe përcakton masat për kufizimin e përhapjes së parazitit karantinor deri në çrrënjosjen e tij.

Urdhri u bëhet i njohur organeve të qeverisjes vendore dhe prodhuesve, personave fizikë e juridikë që merren me kultivimin, prodhimin dhe magazinimin e bimëve dhe të produkteve bimore.

#### Neni 18

### **Blokimet**

Inspektori bllokoi bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera kur vëren se ka shkelje të neneve 13, 14 dhe 16 të këtij ligji.

Menjëherë pas bllokimit, inspektori njofton me shkrim zotëruesin e tyre për kohën dhe arsyen e bllokimit.

#### Neni 19

### **Shumëzimi i parazitëve për qëllime kërkimore**

Mbajtja dhe shumëzimi i parazitëve karantinorë për qëllime kërkimore dhe eksperimentale lejohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, kur ai gjykon se institucioni kërkimor zotëron mjetet e nevojshme që garantojnë me protokoll të veçantë mospërhapjen e parazitit karantinor.

#### Neni 20

### **Rregullat për inspektimin karantinor fitosanitar**

Rregullat për inspektimin karantinor fitosanitar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

KREU V  
PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Neni 21  
**Regjistrimi i PMB-ve**

Të gjitha PMB-të që hyjnë dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen procedurës së regjistrimit.

Neni 22  
**Institucionet vlerësuese të PMB-ve**

1. Institucionet për vlerësimin e PMB-ve gjatë procedurës së regjistrimit janë:
  - a) Instituti i Mbrojtjes së Bimëve, i cili bën vlerësimin biologjik dhe agronomik;
  - b) Instituti i Kërkimeve Veterinare, i cili bën vlerësimin toksikologjik në kafshë;
  - c) Instituti i Shëndetit Publik, i cili bën vlerësimin toksikologjik në njerëz;
  - ç) Ministria e Mjedisit, e cila bën vlerësimin e ndikimit në mjedis.
2. Rregullat e regjistrimit dhe kriteret e vlerësimit të PMB-ve nga institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Mjedisit.

Neni 23  
**Importimi dhe tregtimi**

1. Lejohet importimi dhe tregtimi i PMB-ve të regjistruara.
2. Importimi i PMB-ve të regjistruara kryhet me leje importi, të lëshuar nga Drejtori i Drejtorisë së Mbrojtjes së Bimëve, bazuar në propozimin e dhënë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.
3. Tregtimi i PMB-ve kryhet me leje tregtimi, të lëshuar nga drejtori i drejtorisë rajonale të bujqësisë dhe ushqimit, bazuar në propozimin e dhënë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

Neni 24  
**Transporti, ruajtja dhe përdorimi**

1. Transporti i PMB-ve kryhet me mjete të sigurta dhe të përshtatshme.
2. Ruajtja e PMB-ve bëhet në mjedise të caktuara për këtë qëllim, larg qendrave të banuara dhe atyre publike, për të mënjeluar ndikimet negative në mjedis.
3. PMB-të përdoren duke respektuar kërkesat dhe udhëzimet, që jepen në dokumentin e regjistrimit.

Neni 25  
**Kualifikimi**

1. Të drejtën e importimit dhe tregimit të PMB-ve e kanë personat e diplomuar në fushën e agronomisë, ose që kanë të punësuar persona të diplomuar në fushën e agronomisë.
2. PMB-të shumë helmues (klasa 1a) dhe helmues (klasa 1b) përdoren vetëm nga personat e përmendur në pikën 1 të këtij neni, si dhe nga ata që janë të instruktuar e të pajisur me dëshmi aftësie.

Neni 26  
**Akte nënligjore për PMB-të**

Rregullat për importimin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e

PMB-ve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit.

## KREU VI KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE

### Neni 27

#### **Kundërvajtje administrative**

Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme të dispozitave të këtij ligji:

1. Moszbatimi nga personat fizikë e juridikë të kërkesave të nenit 8 të këtij ligji.
2. Moszbatimi nga subjektet shtetërore dhe private të kërkesave të pikës 1 të nenit 10 të këtij ligji.
3. Përdorimi i materialeve bimore për shumëzim ose mbjellje pa iu nënshtruar inspektimit fitosanitar dhe pa u pajisur me certifikatë fitosanitare, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 11 të këtij ligji.
4. Importi, eksporti dhe kalimi tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera, në kundërshtim me kërkesat e nenit 13 të këtij ligji.
5. Importi, eksporti dhe kalimi tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë i bimëve, i produkteve bimore dhe i objekteve të tjera, si dhe shumëzimi dhe kultivimi i bimëve, në kundërshtim me kërkesat e nenit 14 të këtij ligji.
6. Mosrespektimi i detyrimeve për njoftimin e rasteve të shfaqjes së një paraziti të ri ose të shtimit masiv të tij, në kundërshtim me kërkesat e nenit 16 të këtij ligji.
7. Përdorimi në territorin e Republikës së Shqipërisë i PMB-ve, në kundërshtim me kërkesën e nenit 21 të këtij ligji.
8. Importimi dhe tregtimi i PMB-ve, në kundërshtim me kërkesat e neneve 23 dhe 25 pika 1 të këtij ligji.
9. Transporti, ruajtja dhe përdorimi i PMB-ve, në kundërshtim me kërkesat e nenit 24 të këtij ligji.
10. Përdorimi i PMB-ve të veçanta, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2 të nenit 25 të këtij ligji.

### Neni 28

#### **Sanksione**

1. Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 6 të nenit 27 të këtij ligji, nga inspektori jepen dënime me gjobë 5 000 lekë.
2. Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në pikat 3, 4, 5 dhe 10 të nenit 27 të këtij ligji, nga inspektori jepen dënime me gjobë 10 000 lekë.
3. Për kundërvajtjet administrative të parashikuara në pikën 9 të nenit 27 të këtij ligji, nga inspektori jepen dënime me gjobë 15 000 lekë.
4. Për kundërvajtjet administrative të parashikuara në pikat 7 e 8 të nenit 27 të këtij ligji, nga inspektori jepen dënime me gjobë 20 000 lekë.

### Neni 29

#### **Procedurat e kundërvajtjes administrative**

1. Të drejtën e dhënies së masës administrative, siç është përcaktuar në nenin 27, e ka inspektori.
2. Kundër vendimit të inspektorit mund të bëhet ankim me shkrim te Drejtori i Mbrojtjes së Bimëve brenda 5 ditëve nga shpallja ose marrja e njoftimit të vendimit.

Drejtori i Mbrojtjes së Bimëve duhet t'i përgjigjet ankimit brenda 10 ditëve nga paraqitja e tij.

3. Kundër vendimit të Drejtorit të Mbrojtjes së Bimëve, ose kur ai nuk përgjigjet sipas afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor, ku është kryer kundërvajtja, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e marrjes së njoftimit të vendimit.

Neni 30

#### **Ekzekutimi i vendimit**

Ekzekutimi i vendimit kryhet sipas procedurave të përcaktuara në nenet 19 dhe 20 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

KREU VII

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 31

#### **Akte nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, 20, 22 pika 2 dhe 26 të këtij ligji.

Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 12 të këtij ligji.

Neni 32

#### **Shfuqizime**

Ligji nr.7662, datë 19.1.1993 "Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 33

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4536, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**

**LIGJ**

**Nr. 9363, datë 24.3.2005**

### **PËR MËNYRËN DHE PROCEDURAT E VENDOSJES DHE KALIMIT TË FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI DHE PËR DËRGIMIN E FORCAVE USHTARAKE SHQIPTARE JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

## KREU I PARIME TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Objekti

Ky ligj rregullon rastet, mënyrën dhe procedurat e pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar, brenda dhe jashtë vendit, duke respektuar Kushtetutën, Kartën e Kombeve të Bashkuara, parimet e Organizatës së Atlantikut të Veriut, dokumentet e sigurisë së Bashkimit Europian dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

### Neni 2 Bashkëpunimi ushtarak ndërkombëtar

1. Për qëllimet e këtij ligji, me pjesëmarrje në bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar kuptojmë:

- a) pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet ushtarake ndërkombëtare;
- b) pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në stërvitjet ose veprimtaritë ushtarake ndërkombëtare;
- c) qëndrimin e përkohshëm dhe kalimin tranzit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë ligj;
- ç) pjesëmarrjen në misione humanitare ndërkombëtare.

2. Kuvendi i Shqipërisë me ligj mund të vendosë që Republika e Shqipërisë të marrë pjesë edhe në forma të tjera bashkëpunimi ushtarak ndërkombëtar.

3. Rregullimet e bëra nga ky ligj nuk zbatohen për atashetë ushtarakë shqiptarë, të akredituar në një shtet të huaj, dhe për vartësit e tyre, si dhe për atashetë ushtarakë të shteteve të tjera, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, dhe për vartësit e tyre.

### Neni 3 Operacionet ushtarake ndërkombëtare

Për qëllime të këtij ligji, operacione ushtarake ndërkombëtare janë:

1. Operacionet e vetëmbrojtjes kolektive, që kryhen në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara me ligj e të bazuara në të drejtat e njohura nga neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara, ose për të përmbushur detyrime të tjera ligjore.

2. Operacionet ushtarake, që kryhen për të mbajtur dhe rivendosur paqen, në përputhje me kapitujt VI e VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe operacione të tjera ushtarake, të ndërmarra në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.

3. Operacionet ushtarake ndërkombëtare të organizuara, të autorizuara ose të drejtuara nga Organizata e Atlantikut të Veriut (NATO).

### Neni 4 Delegimi i autoritetit të komandimit

Autoriteti kompetent, sipas ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, mund që, për qëllime të bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar, t'i transferojë pjesë të autoritetit të vet komandantit ushtarak të një shteti të huaj ose një organizate ndërkombëtare dhe ai, në të njëjtën mënyrë, mund të pranojë një autoritet, që i jepet nga një komandant ushtarak i një shteti të huaj ose nga një organizatë ndërkombëtare.

KREU II  
OPERACIONET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE JASHTË TERRITORIT  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 5

**Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë  
në operacionet e vetëmbrojtjes kolektive**

1. Kuvendi i Shqipërisë vendos me ligj pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet e vetëmbrojtjes kolektive, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji, me:

a) ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, që përmbajnë dhe shprehin parimin e operacioneve të vetëmbrojtjes kolektive;

b) miratimin, rast pas rasti, në mungesë të marrëveshjeve ndërkombëtare, të përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni.

2. Këshilli i Ministrave, në mbështetje të pikës 1 të këtij neni, vendos, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, pjesëmarrjen në operacionet e vetëmbrojtjes kolektive të njëjësive të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Presidenti dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë njoftohen paraprakisht për vendimet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

Neni 6

**Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë  
në operacionet ushtarake ndërkombëtare**

1. Kuvendi i Shqipërisë, vendos me ligj pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji, rast pas rasti, duke përcaktuar misionin dhe nivelin e pjesëmarrjes, përveçse kur është përcaktuar ndryshe nga një marrëveshje ndërkombëtare.

2. Këshilli i Ministrave vendos për statusin dhe mënyrat e pjesëmarrjes së njëjësive të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet ushtarake ndërkombëtare të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Presidenti dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë njoftohen menjëherë për vendimet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

4. Ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që shërbejnë në operacionet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, gëzojnë përfitime sociale, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rasteve kur ky ligj ose një marrëveshje ndërkombëtare, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, shprehin ndryshe.

5. Këshilli i Ministrave me vendim mundëson lidhjen e një kontrate sigurimi në dobi të ushtarakëve, që shërbejnë në njësitë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe përmbushin qëllimet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, e cila siguron pagesën ose një kompensim shtesë në rast vdekjeje.

Neni 7

**Operacionet ushtarake ndërkombëtare të organizuara,  
të autorizuara ose të drejtuara nga NATO-ja**

1. Kuvendi i Shqipërisë, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, vendos, brenda 7 ditëve nga data e bërjes së kërkesës, për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 3 të këtij ligji, rast pas rasti, duke përcaktuar misionin dhe nivelin e pjesëmarrjes, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe nga një marrëveshje ndërkombëtare.

2. Kërkesa e Këshillit të Ministrave duhet të përmbajë të dhënat, veçanërisht për:

a) detyrën e misionit;

- b) vendin e kryerjes së misionit;
- c) ligjet bazë të kryerjes së misionit;
- c) numrin maksimal të ushtarakëve që do të dërgohen në këtë mision dhe aftësinë për mision të këtyre trupave;
- d) kohën e zgjatjes së këtij misioni;
- dh) koston financiare të parashikuar.

#### Neni 8

### **Stërvitjet ushtarake ndërkombëtare**

1. Për qëllime të bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar dhe për përgatitje të mbrojtjes kombëtare, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mund të marrin pjesë në stërvitjet ushtarake ndërkombëtare, që zhvillohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ose në veprimtari të tjera të organizuara, të autorizuar apo të drejtuara nga NATO-ja ose nga vende anëtare të marrëveshjes PfP SOFA.

2. Vendimi për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në stërvitje e në veprimtari ushtarake ndërkombëtare jashtë vendit merret:

- a) deri në nivel toge, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes;
- b) deri në nivel kompanie, me vendim të Këshillit të Ministrave;
- c) mbi nivel kompanie, me ligj nga Kuvendi.

3. Institucionet vendimmarrëse, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, njoftojnë, paraprakisht, Presidentin e Republikës dhe autoritetet eprore të komandimit e të drejtimit.

#### Neni 9

### **Vendimi për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misione humanitare ndërkombëtare**

1. Vendimi për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misione humanitare ndërkombëtare jashtë vendit merret nga Këshilli i Ministrave, me pëlqimin paraprak të Kuvendit.

2. Kërkesa e Këshillit të Ministrave për këto raste shqyrtohet nga Kuvendi brenda 7 ditëve.

#### Neni 10

### **Caktimi i ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare**

Ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë caktohen në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, në përmbushje të detyrimeve të vendosura në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

#### KREU III

### **BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### Neni 11

### **Qëndrimi i forcave të huaja ushtarake në territorin e Republikës së Shqipërisë**

Forcat ushtarake të huaja mund të qëndrojnë përkohësisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas procedurave të vendosura në këtë ligj, nëse kanë si qëllim:

a) pjesëmarrjen në operacionet e vetëmbrojtjes kolektive, të ndërmarra në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas pikës 1 të nenit 3 të këtij ligji;

- b) pjesëmarrjen në operacione të tjera ndërkombëtare ushtarake, të ndërmarra në përputhje me pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji;
- c) pjesëmarrjen në bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar, të ndërmarrë në përputhje me pikën 3 të nenit 3 të këtij ligji;
- ç) pjesëmarrjen në stërvitjet dhe në veprimtaritë ushtarake ndërkombëtare;
- d) pjesëmarrjen në veprimtaritë e shtabeve ushtarake ndërkombëtare;
- dh) kalimin tranzit të forcave ushtarake të huaja, me lejen e një autoriteti kompetent të Republikës së Shqipërisë;
- e) operacione të tjera ushtarake, përfshirë edhe projekte të përbashkëta mbrojtjeje, me miratimin e autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë;
- ë) misione humanitare ndërkombëtare brenda vendit.

#### Neni 12

### **Dhënia e lejeve të qëndrimit forcave ushtarake të huaja për pjesëmarrje në operacionet ushtarake ndërkombëtare të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë**

1. Dhënia e lejes forcave ushtarake të huaja për qëndrim të përkohshëm, për pjesëmarrje në operacione kolektive të vetëmbrojtjes ose në operacione ushtarake ndërkombëtare, të ndërmarra në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas pikave 1 e 2 të nenit 3 të këtij ligji, bëhet:

- a) me ligj nga Kuvendi, në mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare, që mishëron parimet e vetëmbrojtjes kolektive;
- b) me vendim të Këshillit të Ministrave, për operacionet që ndërmerren sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë dhe shtete të tjera janë palë, dhe Kuvendi, me ligj, ia deleguar këtë kompetencë Këshillit të Ministrave.

2. Procedura e përcaktuar në këtë nen zbatohet edhe gjatë qëndrimit të përkohshëm të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse qëllimi i qëndrimit të përkohshëm është të marrin pjesë në operacionet ushtarake ndërkombëtare, të ndërmarra në territorin e një shteti tjetër.

#### Neni 13

### **Operacionet ushtarake ndërkombëtare të organizuara, të autorizuar ose të drejtuara nga NATO-ja**

Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, vendos, brenda 7 ditëve nga data e bërjes së kërkesës, për dhënien e lejeve forcave ushtarake të huaja për pjesëmarrje në operacionet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 3 të këtij ligji, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, rast pas rasti.

#### Neni 14

### **Dhënia e lejeve të qëndrimit të përkohshëm forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë në raste të tjera**

1. Vendimi për pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në stërvitje të përbashkëta ushtarake ndërkombëtare, në veprimtari të organizuara, të autorizuar ose të drejtuara nga NATO-ja apo nga vendet anëtare të PfP SOFA-s në territorin e Republikës së Shqipërisë, për numër të përgjithshëm pjesëmarrësish, merret:

- a) deri në 100 veta, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes;
- b) deri në 500 veta, me vendim të Këshillit të Ministrave;
- c) mbi 500 veta, me ligj nga Kuvendi.

Për stërvitjet që zgjasin mbi 30 ditë, autoriteti kompetent për dhënien e këtyre lejeve është Kuvendi.

2. Për zbatimin e projekteve dhe të programeve të ndihmës dhe të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, dhënia e lejes për qëndrim të përkohshëm, në zbatim të marrëveshjeve të ratifikuara nga Kuvendi, bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

3. Institucionet vendimmarrëse, të përcaktuara në këtë nen, njoftojnë, paraprakisht, Presidentin e Republikës dhe autoritetet eprore të komandimit e të drejtimit.

#### Neni 15

### **Vendimi për pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në misione humanitare në territorin e Republikës së Shqipërisë**

1. Këshilli i Ministrave, me pëlqimin e Kuvendit, vendos për pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në misione humanitare në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Kërkesa e Këshillit të Ministrave për këto raste shqyrtohet nga Kuvendi brenda 7 ditëve.

#### Neni 16

### **Kalimi tranzit i forcave ushtarake të huaja**

1. Për qëllimet e këtij ligji, me "tranzit" kuptohet kalimi i forcave ushtarake të huaja për në territorin e një shteti tjetër, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Dhënia e lejes së tranzitimit bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kërkesës për kalimin tranzit të forcave ushtarake të huaja nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë duhet t'i bashkëlidhet edhe miratimi zyrtar i shtetit, për ku janë drejtuar këto forca.

4. Forcat ushtarake të huaja, gjatë kalimit tranzit nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, shoqërohen nga një njësi ushtarake e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Presidenti i Republikës dhe Kuvendi njoftohen, paraprakisht, për kërkesën për kalimin tranzit. Kuvendi mund t'i shfuqizojë lejkalimet e lëshuara sa më sipër, t'i zëvendësojë ose t'i ndryshojë ato.

#### Neni 17

### **Procedurat e mbërritjes, të qëndrimit dhe të largimit të forcave ushtarake të huaja nga territori i Republikës së Shqipërisë**

1. Pjesëtarëve të shërbimit të forcave ushtarake të huaja, kur hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund t'u kërkojnë dokumentet e mëposhtme:

a) pasaporta ose karta zyrtare e identifikimit personal, me fotografi, e lëshuar nga shteti dërgues, ku shënohen emri, data e lindjes, pozita, numri (nëse ka) dhe lloji i shërbimit;

b) urdhri për lëvizje, kolektiv ose individual, i lëshuar në gjuhën e shtetit dërgues, si dhe në anglisht e frëngjisht, nga institucioni përkatës i shtetit apo organizatës dërguese, e cila vërteton statusin e individit ose të grupit, si pjesëtarë të një force dhe të një urdhri për lëvizje.

2. Personeli civil, që shoqëron forcën ushtarake të huaj ose vartësit e tyre duhet të mbajnë pasaportën apo një dokument identifikimi të pranuar.

3. Pjesëtarëve të forcave ushtarake të huaja, në hyrje të territorit të Republikës së Shqipërisë mund t'u kërkojë të paraqesin një certifikatë shëndetësore zyrtare, të lëshuar nga autoritetet e tyre, në përputhje me rregullat ndërkombëtare, të njohura dhe të pranuar nga autoritetet shqiptare, me të cilën të vërtetojnë se nuk janë të prekur nga sëmundje infektive.

4. Nëse siguria dhe rendi publik i shtetit shqiptar rrezikohen nga një pjesëtar i forcave ushtarake të huaja, ushtarak ose civil, organi kompetent i shtetit shqiptar, kryesisht ose me kërkesë të personit të interesuar, kërkon largimin e menjëhershëm të tij. Në marrëveshjet për statusin e forcave autoritetet e shtetit dërgues plotësojnë kërkesa të tilla largimi dhe sigurojnë pranimin e pjesëtarit në territorin e këtij shteti.

Neni 18  
**Regjistrimi**

1. Pjesëtarët e forcave ushtarake të huaja, si subjekte që u nënshtrohen formaliteteve të përcaktuara në legjislacionin shqiptar në fuqi, përjashtohen nga detyrimet për vizat dhe kontrolli i imigrimit, kur hyjnë apo dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë. Ata përjashtohen, gjithashtu, nga rregullat për regjistrimin dhe kontrollin e të huajve në zyrat e regjistrimit, në pikat e kalimit të kufirit.

2. Për regjistrimin në hotele, në shtëpitë e pushimit, në spitale, në infirmieri ose në mjedise të njëjta apo të ngjashme, si dhe për marrjen e së drejtës për rezidencë ose banim të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, zbatohen rregullat e përgjithshme dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

3. Pjesëtarët e forcave ushtarake të huaja dhe vartësit e tyre përjashtohen nga procedurat e imigrimit, të përcaktuara në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 19  
**Procedurat për dhënien e lejeve për mjetet ushtarake**

1. Dhënia e lejeve për mjetet ushtarake të huaja (automjete, anije), që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes ose të një personi të autorizuar prej tij.

2. Dhënia e lejeve për avionët dhe mjetet e tjera fluturuese, që u përkasin forcave ushtarake të huaja, për hyrjen në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, si dhe për uljen e fluturimit, bëhet me urdhër të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit ose nga personi i autorizuar prej tyre.

3. Dhënia e lejeve për anijet dhe mjetet e tjera lundruese, që u përkasin forcave ushtarake të huaja, për hyrjen në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë, si dhe për ankorimin dhe futjen në portet tregtare, bëhet me urdhër të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit ose nga personi i autorizuar prej tyre, ndërsa për ankorimin në portet ushtarake të Republikës së Shqipërisë, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

4. Këshilli i Ministrave vendos për rastet dhe procedurat për dhënien e lejeve për mjetet ushtarake të huaja, për hyrjen në territorin ose në ujërat e brendshme territoriale të Republikës së Shqipërisë dhe dhënien e lejeve për avionët e mjetet e tjera fluturuese, që u përkasin forcave ushtarake të huaja, për hyrjen në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, për uljen e fluturimit e tyre, si dhe për raste të veçanta.

5. Lejet e përcaktuara në këtë nen mund të jenë të vlefshme për një ose më shumë hyrje.

**KREU IV**  
**STATUSI I FORCAVE USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**DHE FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA**

Neni 20  
**Marrëveshjet për statusin e forcave ushtarake**

1. Republika e Shqipërisë, mbështetur në legjislacionin në fuqi, mund të nënshkruajë dhe të miratojë marrëveshje ndërkombëtare, për t'u dhënë status ligjor Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që shkojnë në një vend tjetër, ose forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për zbatimin e marrëveshjeve për statusin e këtyre forcave.

3. Ministri i Mbrojtjes nënshkruan marrëveshje teknike, për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve për statusin e këtyre forcave.

4. Anëtarët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (përfshirë edhe personelin civil) dhe vartësit e tyre, kur janë në territorin e një shteti të huaj, janë subjekt i ligjit shqiptar, për sa kohë kjo është në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

5. Anëtarët e një force ushtarake të huaj dhe vartësit e tyre janë subjekt i ligjit shqiptar, kur janë në territorin e këtij të fundit, përveçse kur shprehet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare dhe në rregullat e parimet e pranuar të legjislacionit ndërkombëtar.

6. Në kuptim të këtij ligji, një person është vartës nëse:

a) është identifikuar si i tillë në dokumentin e tij/saj të udhëtimit;

b) statusi i tij/saj është përcaktuar si i tillë në një marrëveshje ndërkombëtare;

c) statusi i tij/saj si vartës konfirmohet nga shteti, shtetësinë e të cilit ai/ajo ka, ose nga shteti nga vijnë këto forca ushtarake të huaja.

#### Neni 21

### **E drejta e ushtrimit të juridiksionit**

Autoriteve të autorizuara nga shteti dërgues i forcave ushtarake të huaja u jepet e drejta të ushtrojnë juridiksionin, disiplinor dhe penal, mbi pjesëtarët e forcave ushtarake dhe vartësit e tyre, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse kjo e drejtë u jepet nga ligji i shtetit dërgues të forcës ushtarake të huaj, për sa kjo është në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, me parimet dhe rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

#### Neni 22

### **Zgjidhja e ankesave**

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, përcakton procedurat për zgjidhjen, dëmshpërblimin dhe heqjen dorë nga pretendimet jokontraktore, që lindin nga bashkëpunimi ushtarak ndërkombëtar.

2. Ky nen nuk zbatohet për bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar të përmendur në nenin 3 të këtij ligji.

#### Neni 23

### **E drejta e mbajtjes së uniformës**

Pjesëtarët e forcës ushtarake të huaj në kufi, gjatë kalimit tranzit dhe qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë mbajnë uniformë, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshje.

#### Neni 24

### **Vlefshmëria e licencave dhe e patentave**

1. Patenta, licenca e fluturimit, licenca e lundrimit dhe licencat e tjera, lëshuar anëtarëve të forcave ushtarake të huaja ose vartësve të tyre nga një shtet i huaj, janë të vlefshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me procedurat dhe qëllimet e këtij ligji.

2. Ministria e Mbrojtjes, nëse është e nevojshme, u kërkon autoriteteve kompetente të forcave ushtarake të huaja të konfirmojnë vlefshmërinë e licencave e të patentave, të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 25

**Përfundimi nga regjistrimi i mjeteve të forcave ushtarake të huaja**

Në vijim të procedurës dhe të qëllimeve të përcaktuara nga ky ligj, mjetet, që u përkasin forcave ushtarake të huaja, të cilat janë të regjistruara në shtetin e huaj dhe mbajnë numër të lëshuar nga ky shtet, përfundohen nga regjistrimi në Republikën e Shqipërisë.

**KREU V  
DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 26

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4537, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Alfred Moisiu**

**LIGJ  
Nr. 9364, datë 31.3.2005**

**PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS “PËR PJESËMARRJEN  
E TË HUAJVE NË JETËN PUBLIKE, NË NIVEL LOKAL””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa “Për pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike, në nivel lokal””.

Neni 2

Në përputhje me pikën 1 të nenit 1 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se rezervon të drejtën të mos zbatojë dispozitat e kapitullit “C” të Konventës.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4538, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Alfred Moisiu**

**KONVENTA**  
**PËR PJESËMARRJEN E TË HUAJVE NË JETËN PUBLIKE NË NIVEL LOKAL**

Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nëshkruese këtu,

*duke pasur* parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është të arrijë në një unitet sa më të madh mes anëtarëve të saj, me qëllim mbrojtjen dhe realizimin e idealeve dhe parimeve, të cilat janë trashëgimi e përbashkët, si dhe lehtësimin e progresit ekonomik e social duke respektuar ndërkohë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore;

*duke ripohuar* përkushtimin e tyre ndaj natyrës së përgjithshme dhe të pandashme të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, bazuar në dinjitetin e qenieve njerëzore;

*duke pasur* parasysh nenet 10, 11, 16 dhe 60 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;

*duke pasur* parasysh se qëndrimi i të huajve në territorin kombëtar, tashmë është një tipar i qëndrueshëm i shoqërive europiane;

*duke pasur* parasysh se banorët e huaj kryesisht kanë të njëjtat detyra si shtetas në nivelin lokal;

*të vetëdijshme* për pjesëmarrjen aktive të banorëve të huaj në jetën e komunitetit lokal dhe zhvillimin e begatisë së saj dhe të bindur për nevojën e përmirësimit të integritetit të tyre në komunitetin lokal, veçanërisht nëpërmjet rritjes së mundësive të tyre për pjesëmarrje në çështjet lokale publike,

ranë dakord si më poshtë:

**PJESA I**

**Neni 1**

1. Çdo palë do të zbatojë dispozitat e kapitujve A, B dhe C. Megjithatë, çdo shtet nënshkrues i Konventës mund të deklarojë, kur të depozitohet instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo anëtarësimit, se ruan të drejtën për të mos zbatuar dispozitat e kapitullit B dhe C ose të asnjërit prej tyre.

2. Çdo palë, e cila ka deklaruar se do të zbatojë një apo dy kapituj, mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm, në çdo kohë të mëvonshme, se pranon të zbatojë dispozitat e kapitullit apo kapitujve, të cilët ai nuk i kishte pranuar në momentin e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo anëtarësimit.

**Neni 2**

Për qëllime të kësaj Konvente termi “Banorë i huaj” nënkupton personat që nuk janë shtetas të një shteti dhe të cilët janë ligjërisht banorë të territorit të këtij vendi.

**KAPITULLI A**  
**LIRITË E SHPREHJES SË MENDIMIT,**  
**GRUMBULLIMIT DHE GRUPIMIT NË SHOQATA**

**Neni 3**

Çdo palë ndërmerr, në përputhje me dispozitat e nenit 9, t’u garantojë banorëve të huaj, me të njëjtat kushte si shtetasve të saj:

a) Të drejtën e lirisë së të shprehurit; kjo e drejtë duhet të përfshijë lirinë për të dhënë mendime, për të marrë dhe transformuar ide dhe informacion pa ndërhyrjen e autoritetit publik dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk duhet të ndalojë shtetet nga të kërkuarit e autorizimit të

transmetimit televiziv apo të sipërmarrjeve të kinemave.

b) Të drejtën e lirisë së grumbullimeve paqësore dhe lirinë e shoqërimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën për të formuar dhe për t'u bashkuar në organizata tregtare për mbrojtjen e interesave të tyre. Kryesisht, e drejta për lirinë e shoqërimit duhet të nënkuptojë të drejtën e banorëve të huaj për të formuar shoqatat e tyre lokale për qëllime të ndihmës së ndërsjellë, ruajtjes dhe shfaqjes së identitetit kulturor apo mbrojtjes së interesave të tyre në lidhje me çështjet që përfshihen brenda territorit të autoritetit lokal, si dhe të drejtën për t'u bashkuar në ndonjë shoqatë.

#### Neni 4

Çdo palë duhet të përpiqet të sigurojë se përpjekje të arsyeshme janë bërë për të përfshirë banorët e huaj në pyetësorët publikë, procedurat e planifikimit dhe procese të tjera të konsultimit mbi çështjet lokale.

### KAPITULLI B ORGANIZMAT KONSULTATIVE PËR TË PËRFAQËSUAR BANORËT E HUAJ NË NIVEL LOKAL

#### Neni 5

1. Çdo Palë ndërmerr, në përputhje me dispozitat e nenit 9 paragrafi 1:

a) Të sigurojë se nuk ka pengesa ligjore apo të tjera për të ndaluar autoritetet vendore, në territorin e të cilave ka një numër të konsiderueshëm të banorëve të huaj, të ngrenë organizma të përshtatshëm konsultativë apo zhvillimi i marrëveshjeve të tjera institucionale të caktuara:

i) të formojë një lidhje ndërmjet midis tyre dhe këtyre banorëve;

ii) të sigurojë një forum për diskutimin dhe formulimin e mendimeve, kërkesave dhe shqetësimeve të banorëve të huaj në çështjet që në mënyrë të veçantë i prekin ato në lidhje me jetën lokale publike, duke përfshirë aktivitetet dhe përgjegjësitë e autoriteteve vendore të interesuara; dhe

iii) të përkrahë integrimin e tyre të përgjithshëm në jetën e komunitetit.

b) Të nxisë dhe të lehtësojë krijimin e organizmave të tilla konsultativë apo organizimeve të tjera institucionale të ngjashme nga autoritetet vendore, në territorin e të cilave ka një numër domethënës të banorëve të huaj për përfaqësimin e këtyre banorëve të huaj.

2. Çdo palë duhet të sigurojë se përfaqësuesit e banorëve të huaj pjesëmarrës në organizmat konsultativë apo organizime të tjera institucionale të cilave u referohet paragrafi 1, mund të zgjidhen nga banorët e huaj në zonën e autoritetit lokal apo të caktohen nga shoqatat e shtetasve të huaj.

### KAPITULLI C E DREJTA PËR TË VOTUAR NË ZGJEDHJET E AUTORITETEVE VENDORE

#### Neni 6

1. Çdo palë, subjekt i dispozitave të nenit 9 paragrafi 1, i jep çdo banori të huaj të drejtën për të votuar dhe qëndruar për zgjedhjet e autoriteteve vendore, me kusht që ai të përmbushë të njëjtat kërkesa ligjore që kërkohen edhe për vendasit dhe, veç kësaj, të ketë qenë banor i ligjshëm dhe i përhershëm në atë shtet në 5 vitet e fundit që u paraprijnë zgjedhjeve.

2. Megjithatë, një shtet palë mund të deklarojë, kur të depozitojë instrumentin e tij të ratifikimit, pëlqimit, miratimit apo anëtarësimit, që synon të kufizojë zbatimin e paragrafit 1, vetëm për të drejtën e votës.

#### Neni 7

Çdo palë në mënyrë të njëanshme apo me marrëveshje dypalëshe, ose shumëpalëshe mund të parashikojë që kërkesa për qëndrim sipas nenit 6 mund të përmbushet për një periudhë më të shkurtër qëndrimi.

## PJESA II

### Neni 8

Çdo palë duhet të përpiqet për të siguruar se informacioni në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre, në lidhje me jetën lokale publike u vihet në dispozicion banorëve të huaj.

### Neni 9

1. Në kohë lufte apo kërcënimi tjetër emergjent publik të jetës së kombit, të drejtat e dhëna banorëve të huaj në pjesën e parë mund të jenë subjekt i kufizimeve të mëtejshme të shtrirjes në një masë jo më të madhe siç e kërkon situata, me kusht që këto kufizime të mos jenë të papajtueshme me detyrimet e kësaj pale sipas së drejtës ndërkombëtare.

2. Meqenëse e drejta e njohur ligjërish nga neni 3.a ka të bëjë me detyra dhe përgjegjësi, ajo mund të jetë subjekt i formaliteteve, kushteve, kufizimeve apo ndëshkimeve të tilla, siç janë përshkruar nga ligji, të nevojshme në shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, paprekshmërisë territoriale apo sigurisë publike, për parandalimin e krimit apo rrëmujave, për mbrojtjen e shëndetit apo zakoneve, për mbrojtjen e reputacionit apo të drejtave të të tjerëve, për parandalimin e zbulimit të informacionit të marrë në mirëbesim, apo për mbajtjen e autoritetit dhe paanësisë së sistemit të drejtësisë.

3. E drejta e njohur nga neni 3.b, mund të mos jetë subjekt i asnjë kufizimi, përveç atyre që janë të përshkruar në ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare apo të asaj publike, për parandalimin e rrëmujës apo krimit, për mbrojtjen e shëndetit apo zakoneve, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

4. Çdo masë e marrë në përputhje me këtë nen, mund t'i njoftohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, i cili do të njoftojë palët e tjera. E njëta procedurë do të zbatohet, kur masa të tilla janë shfuqizuar.

5. Në këtë Konventë, asgjë nuk do të interpretohet si kufizim apo cenim i asnjë prej të drejtave, të cilat mund të garantohen nga ligjet e ndonjë pale apo traktati në të cilën është palë.

### Neni 10

Çdo palë duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për ndonjë dispozitë ligjore apo veprim tjetër të miratuar nga autoritetet kompetente në territorin e tyre që lidhet me detyrat e tij sipas kësaj Konvente.

## PJESA III

### Neni 11

Kjo konventë do të jetë e hapur për nënshkrim për shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Kjo është subjekt i ratifikimit, pranimit apo miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit apo miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

### Neni 12

1. Kjo konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasardhës nga mbarimi i periudhës së tre muajve pas datës në të cilën katër shtete anëtare të Këshillit të Europës kanë shprehur miratimin e tyre për t'u bashkuar në këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 11.

2. Për sa i përket shteteve anëtare, të cilat shprehin pëlqimin e tyre për t'u bashkuar në të, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasardhës nga mbarimi i periudhës tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

### Neni 13

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës për të hyrë në këtë Konventë, me vendimin e marrë nga shumica, e parashikuar në nenin 20.d të Statusit të Këshillit të Europës dhe me votë unanime të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese, që kanë të drejtën për të qenë anëtare të Komitetit.

2. Përsa i përket ndonjë shteti që do të nënshkruajë, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasardhës nga mbarimi i periudhës tremujore, pas datës së depozitimit të instrumentit të pranimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

### Neni 14

Detyrimet e marra në vijim nga palët në Konventë, në përputhje me nenin 1 paragrafi 2, do të vlerësohen si një pjesë përbërëse e ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit të palës që e ka deklaruar dhe do të ketë të njëjtin efekt që nga dita e parë e muajit pasardhës së afatit të mbarimit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

### Neni 15

Dispozitat e kësaj Konvente do të zbatohen në të gjitha kategoritë e autoriteteve vendore që ekzistojnë brenda territorit të çdo pale. Megjithatë, çdo shtet kontraktues, kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo anëtarësimit, të specifikojë kategoritë e autoriteteve territoriale, në të cilat ai synon të kufizojë qëllimin e kësaj Konvente, apo që synon të përjashtojë nga qëllimi i saj.

### Neni 16

1. Çdo shtet në kohën e nënshkrimit apo kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes, mund të specifikojë territorin apo territoret në cilat kjo Konventë do të zbatohet.

2. Çdo shtet në një kohë të mëvonshme, me një deklaratë të adresuar në Këshillin e Europës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në një territor tjetër, përveç atij të specifikuar në deklaratë. Përsa i përket një territori të tillë, Konventa duhet të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasardhës të mbarimit të periudhës prej tre muajsh pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë mbështetur në dy paragrafët e mëparshëm, përsa i përket çdo territori të specifikuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet me një njoftim adresuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të jetë efektive në ditën e parë të muajit pasardhës të mbarimit të periudhës prej gjashtë muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

### Neni 17

Asnjë rezervë nuk mund t'u bëhet dispozitave të kësaj Konvente, përveç atyre të përmendura në nenin 1 paragrafi 1.

### Neni 18

1. Çdo palë mund ta denoncojë në çdo kohë këtë Konventë nëpërmjet njoftimit të adresuar te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Një denoncim i tillë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasardhës të mbarimit të periudhës prej gjashtë muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

## Neni 19

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit dhe ndonjë shtet, i cili ka hyrë në Konventë, për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) çdo depozitim instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit apo anëtarësimit;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenet 12, 13 dhe 16;
- d) çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 1 paragrafi 2;
- e) çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 9 paragrafi 4;
- f) çdo akti tjetër, njoftim apo komunikim në lidhje me këtë Konventë.

Kjo Konventë u nënshkrua në prani të personave të autorizuar për ta nënshkruar.

Bërë në Strasburg, më 5 shkurt 1992 në anglisht dhe në frëngjisht, të dyja tekstet njëlloj autentike, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i transmetojë kopje të vërtetuara çdo shteti anëtar të Këshillit të Europës dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në këtë Konventë.

### **LIGJ**

**Nr. 9365, datë 31.3.2005**

### **PËR PROCEDURAT E NJOHJES SË ZOTËSISË JURIDIKE TË PERSONAVE JURIDIKË KISHTARË TË KISHËS KATOLIKE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 122 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

#### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

#### **Objekti i ligjit**

Ky ligj përmban dispozitat normative për procedurat e njohjes së zotësisë juridike të personave juridikë kishtarë të Kishës Katolike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

#### **Subjektet e ligjit**

Subjekte të këtij ligji janë personat juridikë kishtarë (entet ose institucionet fetare të Kishës Katolike në Republikën e Shqipërisë), të themeluara nga autoriteti kompetent kishtar, në përputhje me të Drejtën Kanonike (Kodi Ligjor i Kishës Katolike).

#### **KREU II PARIME TË PËRGJITHSHME**

Neni 3

#### **Parimi i pavarësisë nga shteti**

Personat juridikë kishtarë të Kishës Katolike në Republikën e Shqipërisë e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur nga organet shtetërore dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4  
**Të drejtat dhe detyrimet**

Personat juridikë kishtarë gëzojnë të gjitha të drejtat dhe përmbushin detyrimet e parashikuara në dispozitat e Kodit Civil dhe në aktet e tjera ligjore në fuqi për të gjithë personat juridikë.

KREU III  
**PERSONAT JURIDIKË KISHTARË**

Neni 5  
**Forma e personave juridikë kishtarë**

Themelimi, struktura, organizimi, objekti i veprimtarisë, administrimi, modifikimi dhe mënyrat e mbarimit të personave juridikë kishtarë realizohen në përputhje me të Drejtën Kanonike dhe me këtë ligj.

Neni 6  
**Njohja e personalitetit juridik të personave juridikë kishtarë  
dhe regjistrimi i tyre**

1. Personat juridikë kishtarë, subjekte të këtij ligji, njihen si persona juridikë nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, në bazë të dokumenteve të mëposhtme:

- a) kërkesës për njohjen juridike nga përfaqësuesi ligjor të personit juridik kishtar;
- b) aktit të themelimit të personit juridik kishtar nga autoriteti kompetent kishtar, në përputhje me të Drejtën Kanonike, ku përcaktohen selia, natyra dhe objekti i veprimtarisë;
- c) statutit të personit juridik kishtar, sipas së Drejtës Kanonike, ku përcaktohen përfaqësuesi ligjor, detyrat dhe kompetencat e tij, burimet e financimit dhe mënyrat e mbarimit të personit juridik kishtar të parashikuara në statutet e secilit.

2. Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe të dokumentacionit të mësipërm, bën njohjen e personit juridik kishtar dhe regjistrimin e tij, duke lëshuar vendimin përkatës.

Neni 7  
**Regjistrimi në organet tatimore**

Pas përfundimit të procedurave të regjistrimit në gjykatë, personat juridikë kishtarë kryejnë regjistrimin në organet tatimore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 8  
**Kohëzgjatja dhe shtrirja territoriale e personave  
juridikë kishtarë**

Personat juridikë kishtarë mund ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre për një kohëzgjatje pa afat dhe kjo veprimtari mund të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 9  
**Statusi juridik dhe fiskal**

Personat juridikë kishtarë nuk kanë qëllime fitimi dhe në ushtrimin e veprimtarisë së tyre gëzojnë të gjitha të drejtat dhe lehtësitë fiskale, si dhe përmbushin detyrimet ligjore, si të gjithë personat juridikë jofitimprurës, të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 10  
**Licencimi**

Personat juridikë kishtarë, përveç veprimtarisë së tyre fetare, kanë të drejtë të zhvillojnë edhe veprimtari të tjera, si në fushën e arsimit, atë shoqërore dhe shëndetësore, në përputhje me legjislacionin shqiptar për marrjen e licensave ose të lejeve përkatëse.

KREU IV  
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 11  
**Njohja e zotësisë juridike të personave juridikë kishtarë, që nuk kanë zotësinë juridike ose që janë regjistruar si organizata jofitimprurëse**

Për të fituar njohjen e zotësisë juridike, personat juridikë kishtarë, të pranishëm në Republikën e Shqipërisë, të themeluar nga organi kompetent kishtar, në përputhje me të Drejtën Kanonike, që nuk e gëzojnë zotësinë juridike, si dhe personat e regjistruar si organizata jofitimprurëse para miratimit të këtij ligji duhet që, brenda 2 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të tij, të paraqesin në gjykatë dokumentacionin e përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 12  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4539, datë 13.4.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**

**VENDIM**  
**Nr. 6, datë 15.4.2005**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“	“
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 1.10.2004 dhe 22.10.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.23/3 Akti që i përket:

**KËRKUES:** DRITA SILIQI, GJINOVEFA MIHALI, ANDREA E MARINA SHUNDI, përfaqësuar nga avokat Agim Tartari, me prokurë të posaçme.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. KOMISIONI I KTHIMIT DHE I KOMPENSIMIT TË PRONAVE ISH-PRONARËVE TIRANË, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit, Delo Isufi.

2. AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT, përfaqësuar nga Lefteri Lleshi, me autorizim dhe Delo Isufi, Avokat i Shtetit.

3. BASHKIA TIRANË, përfaqësuar nga Lindita Troja, me autorizim.

4. EKREM BARDHA, përfaqësuar nga avokat Krenar Loloçi, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.3357, datë 16.11.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1216, datë 13.12.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.467, datë 24.4.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41/1 e 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**Kërkuesit** kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore:

- Privatizimi i tre lokaleve është bërë pa ankand dhe kjo ka cenuar të drejtën e tyre për të konkurruar si ish-pronarë të truallit në këtë privatizim;

- Agjencia Kombëtare e Privatizimit nuk mund ta shiste truallin, sepse ky i fundit ishte bërë më parë pronë e kërkuesve dhe ishte regjistruar si i tillë në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në këtë mënyrë është cenuar parimi i mbrojtjes së barabartë të llojeve të pronave;

- Shitja e truallit personave të tretë mund të bëhej vetëm pasi të përfundonte kompensimi fizik i ish-pronarëve, ndryshe cenohen të drejtat kushtetuese për të pasur pronë private e për ta trashëguar, si dhe të drejtat e mosshpronësimit e të garantimit të pronës;

- Në gjykimin e çështjes, megjithëse është ndryshuar si shkaku i padisë ashtu edhe objekti i saj, gjykatat nuk pushuan çështjen, por vazhduan gjykimin;

- Gjykata ka dalë tej caqeve të objektit të padisë. Ajo ka mohuar të drejtën për parablerjen e lokaleve, megjithëse nuk ishte kërkuar nga subjektet e interesuara;

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konfondon të drejtën tonë të pronësisë mbi truallin me bashkëpronësinë në lokale, duke keqinterpretuar vendimin nr.4, datë 8.4.1994 të Gjykatës Kushtetuese;

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka bërë më shumë analizën e provave sesa ka trajtuar ligjin.

**Subjektet e interesuara kanë parashtruar:**

- Neni 23 i ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, lejonte që kalimi i pronës shtetërore në pronë private të bëhej edhe në forma të tjera, veç atyre të shprehura në ligj.

- Pretendimet për privatizimin pa ankand nuk janë ngritur në asnjë prej gjykatave që kanë gjykuar çështjen;

- Pavlefshmëria absolute e kontratës së shitblerjes së truallit është problem material që zgjidhet nga gjykatat e sistemit gjyqësor, por jo nga Gjykata Kushtetuese. Veç kësaj, kjo shitblerje është bazuar në nenin 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, sepse ishte truall i zënë me godina dhe jo truall i lirë siç pretendojnë kërkuesit;

- Ligji i kohës lejonte ndryshimin e shkakut dhe të objektit të padisë njëkohësisht. Megjithatë, në çështjen në shqyrtim, me kërkesën e vetë kërkuesit, është pakësuar vetëm objekti i padisë;

- Neni 17 i ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, që lejonte bashkëpronësinë midis pronarit të lokalit dhe ish-pronarit të truallit, është shfuqizuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese;

- Gjykata e Lartë nuk ka bërë interpretim të provave, por kontrollin e zbatimit të ligjit dhe interpretimin e tij.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuesve që kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që u shprehën për rrëzimin e kërkesës, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

Nga materialet e çështjes rezulton se subjekti i interesuar Ekrem Bardha, duke qenë ortak në ndërmarrjen e përbashkët “Mërgimtari”, ka blerë nga ortaku tjetër, Ndërmarrja Tregtare e Ushqimit e Ushqimit Social Tiranë, në datën 22.3.1993, lokalet: “Birrari”, “Restorant” e “Embëltore”, pas Muzeut Kombëtar Tiranë.

Me vendimin nr.1046, datë 30.12.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Tiranë, kërkuesve Drita Siliqi, Gjinovefa Mihali, Andrea e Marina Shundi, u është njohur e kthyer një sipërfaqe truall prej 2461.97 m<sup>2</sup>, të cilën e regjistruan në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në datën 17.1.1995. Në prill të vitit 1996, gjysma e kësaj sipërfaqeje i shitet subjektit të interesuar, Ekrem Bardha nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit. Lidhur me këto veprime juridike të organeve shtetërore, kanë ngritur padi në gjykatë si kërkuesit ashtu edhe subjekti i interesuar. Kërkuesit kanë kërkuar anulimin e kontratës së shitblerjes së truallit, ndërsa subjekti i interesuar ka kërkuar anulimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.3357, datë 16.11.1999, ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuesve dhe e ka deklaruar të pavlefshme kontratën e shitblerjes së truallit vetëm për sipërfaqen prej 197 m<sup>2</sup> nën lokalin njëkatësh. Ajo ka detyruar subjektin e interesuar të lidhë kontratën e qirasë ose ta riblejë këtë truall nga ish-pronarët. Kjo gjykatë ka pranuar pjesërisht edhe kundërpadinë e subjektit të interesuar, Ekrem Bardha dhe ka anuluar vendimin nr.1046, datë 30.12.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pranë Bashkisë Tiranë, në pjesën që iu jep të drejtë kërkuesve për parablerjen e lokaleve në pronësi të subjektit të interesuar.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1216, datë 13.12.2000, e ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit lidhur me rrëzimin e padisë për kthimin e sipërfaqes në funksion të lokalit prej 194 m<sup>2</sup>, dhe e ka ndryshuar atë duke i rrëzuar padinë edhe për pavlefshmërinë e shitjes së sipërfaqes nën lokal prej 197 m<sup>2</sup>. Kjo gjykatë ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit edhe përsa i përket kundërpadisë duke anuluar vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Tiranë për kthimin e sipërfaqes prej 1284 m<sup>2</sup>, duke e lënë këtë në fuqi për kthimin e gjysmës tjetër prej 1284 m<sup>2</sup>.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.467, datë 24.4.2002, ka lënë në fuqi në tërësi vendimin e gjykatës së apelit, duke e ndryshuar atë e duke anuluar vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për gjithë sipërfaqen e kthyer prej tij prej 2461.97 m<sup>2</sup>. Sipas vendimit të kolegjit civil, kërkuesit duhet të kompensohen për të gjithë këtë sipërfaqe në një nga format që parashikon neni 16 i ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Gjykata Kushtetuese konstaton se pretendimet e palëve, në çështjen në shqyrtim, janë të ndërvarura nga njëra-tjetra dhe kanë të bëjnë me kompetencën e gjykatave të sistemit gjyqësor për zgjidhjen e çështjes konkrete. Në aspektin kushtetues nuk konstatohet që gjykatat të kenë cenuar parimin e mbrojtjes së barabartë të llojeve të pronave. Kthimi i truallit ish-pronarit është bërë në kundërshtim me ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronave, sepse ai ishte i zënë me lokale të blera nga subjekti i interesuar para daljes së ligjit të mësipërm. Parimi i mbrojtjes së barabartë gjen zbatim në rastet kur këto prona përfitojnë mbrojtje të njëjtë ligjore, por jo në rastet kur gëzimi e disponimi i tyre nuk bazohet në ligj.

Në kërkesëpadinë e paraqitur në gjykatën e rrethit në datë 18.2.1997, kërkuesit kanë kërkuar anulimin e kontratës së shitblerjes së truallit nga subjekti i interesuar, për sipërfaqen 1284 m<sup>2</sup>, duke përcaktuar si bazë ligjore nenin 92 të Kodit Civil. Në shtesat e objektit të padisë, kërkuesit kanë kërkuar edhe kthimin e truallit me sipërfaqe 969 m<sup>2</sup>, duke përcaktuar si bazë ligjore nenet 296 e 298 të Kodit Civil. Në kërkesën e datës 14.7.1999, kërkuesit, ndonëse kanë përcaktuar si bazë ligjore vetëm nenet 296 e 298 të Kodit Civil, kanë kërkuar përsëri anulimin e kontratës së shitjes për sipërfaqen prej 392 m<sup>2</sup>.

Vazhdimi i gjykimit nga gjykata pas paraqitjes së shtesave në objektin e padisë nuk përmban elemente të procesit jo të rregullt në kuptimin ligjor. Është e drejta e palëve të disponojnë mbi objektin e padisë dhe të vlerësojnë kërkesat e tyre, duke bërë edhe ndryshimet, shtesat ose pakësimet e objektit të padisë. Gjykata nuk mund t’u diktojë atyre objektin e kërkesës dhe as t’i pengojë ata në

ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes lidhur me këtë objekt. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesit asnjëherë nuk kanë hequr dorë nga anulimi i kontratës së shitblerjes së truallit dhe nga e drejta e tyre për t'iu kthyer ky send e për ta gëzuar atë. Për më tepër, pakësimi i sipërfaqes objekt konflikti dhe vazhdimi i gjykimit mbi bazën e kërkesës së re nuk i ka ndryshuar arsyet e kërimit gjyqësor që kanë mbetur të njëjta si në kërkesëpadinë kryesore, ashtu edhe në ato që e pasuan atë.

Përsa i përket pretendimit tjetër se gjykatat kanë anuluar vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në pikën 1/d (ku i jepet ish-pronarëve e drejta e parablerjes së lokaleve), megjithëse nuk është kërkuar nga subjekti i interesuar, Gjykata Kushtetuese konstaton se kjo shkelje procedurale e lejuar gjatë gjykimit, nuk mund ta bëjë procesin jo të rregullt në kuptimin kushtetues. Parimet e disponibilitetit të objektit të padisë dhe të barazisë së armëve në proces janë pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt. Por nga gjykimi i çështjes nuk rezulton që palët të jenë vënë në pozita të disfavorshme në raport me njëra-tjetrën. Palët kanë realizuar të drejtën e mbrojtjes në gjyq duke dhënë shpjegime edhe për të drejtën e parablerjes së lokaleve. Ato kanë paraqitur provat përkatëse dhe gjykata duke i vlerësuar në raport me ligjin, ka arritur në përfundimin se kjo e drejtë nuk mund të gjejë zbatim në kushtet kur lokalet janë privatizuar nga subjekti i interesuar para se të dilte ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe përderisa gjykata anuloi kthimin e gjithë truallit ish-pronarëve.

Edhe pretendimi tjetër i kërkuesve për mungesën e bazës ligjore të kundërpadisë është i pabazuar. Në kundërpadinë e subjektit të interesuar është kërkuar anulimi pjesërisht i vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, duke u përmendur si bazë ligjore nenet 4, 16 e vijues të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”; udhëzimi nr.3, datë 21.6.1993, pika 1, paragrafët e parë dhe të dytë, për zbatimin e ligjit të mësipërm; ligji nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve” etj. Nëse në ligjin për shitblerjes e trojeve nuk është përcaktuar dispozita përkatëse, kjo mangësi nuk mund të jetë e tillë që të përbëjë proces jo të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues, përderisa pretendimet e ngritura janë shqyrtuar e zgjidhur nga gjykata duke u siguruar të drejtën e dëgjimit dhe duke respektuar parimin e paanësisë në gjykim.

Në kundërshtim me sa ka pretenduar kërkuesi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, shqyrtimin e çështjes e ka përqendruar në kontrollin e ligjshmërisë së vendimit të gjykatës së apelit. Konkluzionet e veta i ka bazuar në provat e administruara e të vlerësuara në gjykatën e apelit.

Kjo e fundit ka pranuar se gjithë sipërfaqja prej 2641.97 m<sup>2</sup> e kthyer nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave është e zënë me ndërtime, lulishte e trotuare, pjesë e një studimi urbanistik. Mbi bazën e këtij vlerësimi, kolegji civil ka arritur në përfundimin se subjekti i interesuar legjitimohet të kërkojë anulimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për gjithë sipërfaqen dhe jo vetëm për një pjesë të saj. Ky qëndrim i Gjykatës së Lartë lidhet me kompetencën e saj për interpretimin e ligjit e kontrollin e zbatimit të tij dhe nuk përbën ndonjë element të procesit jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Në kundërshtim me sa pretendojnë kërkuesit, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nuk konstatohet ndonjë keqinterpretim i frymës dhe i përmbajtjes së vendimit nr.4, datë 8.4.1994 të Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka shfuqizuar nenin 17 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, duke mosnjohur si kthimin ish-pronarëve të trojeve mbi të cilat janë ndërtuar lokale, ashtu dhe bashkëpronësinë në këto lokale të ish-pronarit të truallit me pronarin e lokalit. Duke u nisur nga ky qëndrim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka konsideruar të pabazuar në ligj vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me të cilin u është kthyer kërkuesve trualli i zënë me lokale, si dhe trualli në funksion të këtyre të fundit.

Kërkuesi pretendon gjithashtu se privatizimi i lokaleve pa ankand jo vetëm vjen në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin e mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarisë private të pavarura dhe privatizimit”, por u ka cenuar atyre të drejtën për të konkurruar në privatizim, si dhe të drejtën e parablerjes. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkuesit nuk i janë drejtuar gjykatave të sistemit gjyqësor me padi për të kërkuar pavlefshmërinë e këtyre veprimeve. Sipas nenit 131/f të Kushtetutës shqyrtimi nga juridiksioni kushtetues i ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një

proces të rregullt ligjor mund të bëhet vetëm pasi kërkuesi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

### VENDIM

**Nr. 7, datë 27.4.2005**

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“	“
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“	“
Vjollca Meçaj	Anëtare	e	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 3.12.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.29/9 Akti që i përket:

**KËRKUES:** SIBUEL DURRËSI, përfaqësuar nga avokat Bardhyl Lohja, me prokurë.

**SUBJEKTI I INTERESUAR:** PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.210, datë 11.9.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr.194, datë 21.10.2003 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.206, datë 23.4.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, duke parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të sipërcituara:

- Janë kryer veprime procedurale nga një inspektor i policisë gjyqësore, i cili ishte larguar nga detyra dhe kishte ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin e tij.

- Deklarimet e kërkuesit, në pozitën e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, janë marrë nga oficeri i policisë gjyqësore pa praninë e detyrueshme të mbrojtësit dhe nën presionin e dhunës dhe të torturës.

- Procesverbali i paraqitjes për njohje është bërë në kundërshtim me rregullat procedurale që parashikojnë nenet 171 e 172 të Kodit të Procedurës Penale, shkelje e cila e bën provën të pavlefshme.

- Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, të cilat lidhen me verifikimin e pretendimit për deklarimin e pavlefshmërisë së akteve dhe pyetjen e disa dëshmitarëve për procesverbalin e paraqitjes për njohje.

- Gjykata e Apelit Shkodër në rigjykimin e çështjes ka ndryshuar trupin gjykues, ndërkohë që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur shqyrtimin e kësaj çështjeje nga i njëjti trup gjykues.

- Të gjitha pretendimet janë parashtruar në rekursin drejtuar Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili në kundërshtim me nenet 128 e 432, shkronja “b” të Kodit të Procedurës Penale, nuk i ka shqyrtuar.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuarit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.210, datë 11.9.2002, ka deklaruar fajtor kërkuarin për veprën penale të vjedhjes me përdorim arme dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe e ka dënuar me 10 vjet burgim. Gjykata e Apelit Shkodër e ka prishur këtë vendim dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e prokurorit, ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe pasi ka lënë disa detyra, ia ka dërguar po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit në shkallë të dytë. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.194, datë 21.10.2003, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Pretendimet e kërkuarit për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve gjyqësore të sipërcituara janë përqendruar në disa nga elementet thelbësore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke iu referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale në funksion të neneve 31 shkronja “d”; 32, pika 2 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Për zgjidhjen përfundimtare të ankesës së kërkuarit, Gjykata Kushtetuese i analizoi të gjitha pretendimet e tij në drejtim të respektimit që i kanë bërë gjykatat e zakonshme standardeve kushtetuese që përfshihen në të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Kryesisht, ajo u përqendrua në disa prej tyre, të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me respektimin e së drejtës së mbrojtjes, të mënyrës së marrjes së provave dhe të ndikimit që ato kanë pasur në ecurinë e procesit.

Në nenin 32 pika 2 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim i rëndësishëm është trajtuar nga jurisprudenca shqiptare dhe ajo e Gjykatës së Strasburgut si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor dhe veçanërisht në drejtim të respektimit të së drejtës për t’u mbrojtur, e cila kërkon që i akuzuari të ketë mundësitë e duhura për të njohur dhe komentuar çdo provë që i paraqitet gjykatës.

Në bazë të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, gjykata e ka për detyrë të vlerësojë në tërësi, nëse procedura lidhur me mënyrën se si u siguruan provat ishte e drejtë.<sup>1</sup> Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues nuk mund të mos nënkuptojë që procesi ishte i parregullt.<sup>2</sup> Asnjë gjykatë nuk ka mundësi që, pa dëmtuar dhënien e “përmasës së duhur të drejtësisë”, të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm me metoda të pandershme, por, mbi të gjitha, që janë edhe të kundërligjshme.

Nisur nga këto qëndrime të evidentuara në jurisprudencën europiane, Gjykata Kushtetuese e ka konsoliduar qëndrimin e saj, duke evidentuar dallimin që ekziston në një proces ligjor ndërmjet mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre. Vlerësimi i provave mbetet një çështje për t’u trajtuar nga vetë gjykatat e zakonshme dhe nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet, kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët

<sup>1</sup> Shiko: vendimi në çështjen e “Vindishit kundër Austrisë” i 27 shtatorit të vitit 1990; A.186.

<sup>2</sup> Vendimi “Schenk kundër Zvicrës”, i datës 12.7.1988, A.140, par.46.

dhe mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor, e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete.<sup>3</sup>

Për t'i dhënë një zgjidhje kushtetuese pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të analizojë kuptimin e dispozitave procedurale që lidhen me marrjen e provave në funksion të sistemit të procedimit penal të pranuar dhe të dispozitave kushtetuese që garantojnë rregullsinë e procesit ligjor.

Legjislacioni ynë procedural penal, doktrina, si dhe jurisprudenca gjyqësore e kanë trajtuar gjerësisht mënyrën e marrjes së provave si një aspekt i rëndësishëm i procesit. Marrja e provave, sipas Kodit të Procedurës Penale, merr një kuptim të ri bazuar në sistemin akuzator, duke ndryshuar metodën e të proceduarit në lidhje me marrjen e provave në shqyrtimin gjyqësor, duke hequr dorë përfundimisht nga të gjitha ato norma të cilat sanksiononin pabarazinë e palëve në procesin penal në disfavor të individit dhe të të drejtave të tij.<sup>4</sup> Provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor. Dispozitat e këtij kodi kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën e procedimit penal në të gjitha fazat e tij. Prandaj, mosrespektimi i dispozitave ligjore të vendosura për aktet e procedimit shërben njëkohësisht dhe si shkak pavlefshmërie, që ndikon drejtpërdrejt mbi ecurinë e procesit gjyqësor.

Duke iu referuar rastit në shqyrtim dhe bazuar në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, rezultojnë se provat mbi të cilat është bazuar gjykata në dënimin e kërkuesit janë deklarimet e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime dhe procesverbalit i paraqitjes për njohje, i mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore. Nga dosja gjyqësore nuk konstatohet që kërkuesi të jetë pyetur me cilësinë e të pandehurit, por vetëm në një rast ai është pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Në të njëjtën datë rezultojnë edhe përpilimi i procesverbalit të paraqitjes për njohje. Këto dy të dhëna janë kundërshtuar si nga kërkuesi, ashtu dhe nga dëshmitarët në gjykatën e rrethit dhe në gjykatën e apelit. Deklarata e dhënë përpara oficerit të policisë gjyqësore, pa praninë e mbrojtësit, është kundërshtuar gjatë procesit gjyqësor nga i akuzuari, me arsyetimin se është marrë nën presionin e dhunës dhe të torturës. Për vërtetimin e këtij pretendimi, i gjykuari ka paraqitur kartelën klinike dhe epikrizën e mjekut, në të cilën pasqyrohet se ai “ankon për dhimbje koke, marrje mendsh, të vjella, rrahje të shpeshta të zembrës dhe rreth kyçeve të duarve, në formë byzylyku, vërehet ekimozë me gjerësi 0,5 cm dhe mbi kyçin e dorës së djathtë dërmishje ekimotike me 2 cm gjatësi”.

Sigurisht që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të shqyrtojë gabimet faktike apo juridike, që kanë të bëjnë me themelin e gjykimit, të cilat kryhen nga gjykatat e zakonshme dhe as të provojë vërtetësinë e të dhënave të tilla. Ekziston, pra, parimi në bazë të të cilit problemet lidhur me vlerësimin e provave të administruara në çështjen konkrete, janë në kompetencën e gjykatës vendimdhënëse.<sup>5</sup> Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nuk mund të përjashtojë nga shqyrtimi rastet që i përkasin parimit dhe gjykimit se provat të cilat sigurohen në mënyrë të paligjshme të jenë të pranueshme.

Nga një analizë e hollësishme e dispozitave të sipërcituara, nga të dhënat që pasqyrohen në dosjen gjyqësore, si dhe nga referenca që bëhet në jurisprudencën evropiane, Gjykata Kushtetuese çmon se ndaj kërkuesit është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, për arsye se është dënuar mbi bazën e provave të marra në mënyrë të kundërligjshme.

Megjithëse këto të dhëna janë kundërshtuar në vazhdimësi nga kërkuesi, nga procesverbalit gjyqësor në gjykatën e rrethit dhe në gjykatën e apelit, nuk rezultojnë të jenë respektuar kërkesat e nenit 362 të Kodit të Procedurës Penale. Evidentimi në aspektin e kontrollit kushtetues i mosrespektimit të kërkesave procedurale që lidhet me kundërshtimin e dëshmisë në gjykatë, përbën një çështje të mënyrës së marrjes së provave.

Sipas kuptimit të Kodit të Procedurës Penale, deklarimet e bëra para prokurorit ose policisë gjyqësore nuk përbëjnë prova në vetvete. Në rastin e kundërshtimit të këtyre thënieve në gjykatë, në kuptim të nenit 362 të Kodit të Procedurës Penale, ato nuk janë provë, por vlerësohen nga gjykata

<sup>3</sup> Vendimi nr. 95, datë 27.7.2001 i Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhje vendimesh 2000-2001, faqe 257.

<sup>4</sup> Procedura Penale, Komentar, Tiranë 2003, faqe 210.

<sup>5</sup> Shih më gjerë vendimin në çështjen “Kostovski kundër Holandës” të 20 nëntorit të vitit 1989-A.166.

për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur. Deklarimet e dhëna para tyre, thuhet në pikën 3 të këtij neni, mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre. Parimi i procesit të rregullt përfshin edhe të drejtën e palëve për të njohur dhe për të komentuar çdo provë apo vërejtje, që i është paraqitur trupit gjykues, pavarësisht prejardhjes së tyre.<sup>6</sup>

Gjithashtu, procedura e paraqitjes për njohje, në këtë proces ligjor, rezulton se është zhvilluar në kundërshtim me nenet 171 e 172 të Kodit të Procedurës Penale. Në procesverbalin e paraqitjes për njohje mungon pasqyrimi i hollësishëm i kërkesave ligjore, që lidhen me përshkrimin e personit për të gjitha shenjat që mban mend, pyetjen nëse ka qenë më parë për të bërë njohjen, si dhe rrethanat e tjera që ndikojnë në vërtetësinë e ngjarjes. Mungesa e këtyre elementeve përbën shkak për pavlefshmërinë e paraqitjes për njohje.

Evidentohet nga procesverbali gjyqësor se personi që ka bërë njohjen, dëshmitari, si dhe vetë kërkuesi në seancë gjyqësore, e kanë kundërshtuar në të gjithë elementet procesverbalin e paraqitjes për njohje, duke vënë në dyshim vërtetësinë e saj. Në procesin e njohjes kanë marrë pjesë tre punonjës të policisë, ndërkohë që rezulton se i pandehuri ka qenë realisht i dallueshëm ndërmjet tyre, për arsye të kushteve të rënda fizike dhe shëndetësore që paraqiste. Nuk figuron në procesverbal që të kenë nënshkruar tre personat që pretendohet se kanë marrë pjesë në njohje, ndërkohë që njëri nga dëshmitarët pranon se nuk e ka nënshkruar procesverbalin në datën 25.9.2001, por rreth dy javë pas zhvillimit të njohjes.

Njëkohësisht, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi i avokatit të kërkuesit për pavlefshmërinë e kësaj prove, për arsye të moszhvillimit të seancës së paraqitjes për njohje në datën 25.9.2001, është i drejtë. Në dosje ndodhet urdhri i prokurorit, datë 1.10.2001, nëpërmjet të cilit urdhërohet oficeri i policisë gjyqësore për kryerjen e paraqitjes për njohje. Megjithëse procesverbali i paraqitjes për njohje në kuptim të neneve 171 e 172 të Kodit të Procedurës Penale është kundërshtuar në të gjitha shkallët e gjykimit si shkak për pavlefshmërinë e njohjes, gjykatat e kanë konsideruar atë si provë për dënimin e kërkuesit.

Refuzimi nga ana e gjykatës i kërkesës së mbrojtësit për thirrjen si dëshmitarë të tre personave që kanë shërbyer gjatë paraqitjes për njohje, nuk i ka dhënë atij mundësinë për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtën e mbrojtjes. E drejta e palëve për të paraqitur argumente, sigurohet vetëm në rastin kur ato dëgjohen realisht, pra, kur shqyrtohen nga gjykata në mënyrën e duhur. Nuk mund të thuhet se kjo është bërë, në qoftë se është nënvleftësuar një provë me rëndësi esenciale.<sup>7</sup>

Parë nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese çmon se të pandehurit dhe mbrojtësit të tij nuk u është krijuar mundësia, megjithë kërkesat e shumta në të gjitha shkallët e gjykimit, t'u drejtonin pyetje dëshmitarëve për të kundërshtuar provën në këtë proces penal, duke cenuar të drejtën e mbrojtjes në një masë të papajtueshme me kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 paragrafët 1 e 3, shkronja "d" të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese konkludon se gjatë gjykimit të zhvilluar ndaj kërkuesit, Sibuel Durrësi, janë cenuar elemente thelbësore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 31 shkronja "d"; 32, pika 2, dhe 42 të Kushtetutës, si dhe të nenit 6 pika 3 shkronja "d" të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja "f" dhe 134 pika 1 shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

<sup>6</sup> Vendimi "Niderhost-Huber kundër Zvicrës", i datës 18.2.1997, RJD 1997-I.

<sup>7</sup> Raporti "Fouquet kundër Francës", par. 36 dhe 39 i datës 12.10.1994, ankimi nr. 20398/92, RD 1996-I.

## VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.210, datë 11.9.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr.194, datë 21.10.2003 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.206, datë 23.4.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Shkodër.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

## RREGULLORE

**Nr. 35/1, datë 30.3.2005**

### **PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR.35, DATË 19.6.2002 “PËR SIGURIMIN VULLNETAR NË INSTITUTIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE”**

Në mbështetje të nenit 3 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore në mbledhjen e tij të datës 30.3.2005, bën këto shtesa e ndryshime në rregulloren nr.35, datë 19.6.2002 “Për sigurimin vullnetar në ISSH”.

1. Në kapitullin I “Rregulla të përgjithshme”,

- në pikën 1, përkufizimet e mëposhtme ndryshojnë si vijon:

- me termin “Marrëveshje” kuptohen marrëveshjet tip, që i bashkëlidhen kësaj rregulloreje;

- me termin “Person i interesuar”, kuptohet personi që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe që nënshkruan vetë ose nëpërmjet një personi të tretë marrëveshje për sigurim vullnetar. Kur personi i interesuar banon jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, atëherë ai duhet të jetë shtetas shqiptar;

- me termin “Person i tretë” kuptohet personi që nënshkruan marrëveshje për sigurim vullnetar dhe/ose që kryen pagesën e kontributeve në emër të personit të interesuar;

- me termin “Agjent i sigurimit vullnetar në territorin e Republikës së Shqipërisë” kuptohet individ-i shtetas shqiptar; personat fizikë ose juridikë, të regjistruar në Shqipëri, të kontraktuar nga ISSH-ja, sipas kontratës tip bashkëlidhur kësaj rregulloreje, për të përfshirë në sigurimin vullnetar, persona të interesuar për këtë sigurim;

- me termin “Agjent i sigurimit vullnetar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, kuptohet individ-i shtetas shqiptar; personat fizikë ose juridikë, të regjistruar në Shqipëri, të kontraktuar nga ISSH-ja, sipas kontratës tip bashkëlidhur kësaj rregulloreje, për të përfshirë në sigurimin vullnetar, persona të interesuar për këtë sigurim dhe për të nënshkruar marrëveshje për sigurim vullnetar si përfaqësues të autorizuar të ISSH-së.

- Pika 2, “Qëllimi”, riformulohet si vijon:

“Qëllimi i rregullores është që në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të mundësojë sigurimin vullnetar për personat e interesuar, të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e personave të siguruar dhe përgjegjësitë e ISSH-se në lidhje me to.”

- Në pikën 3 “Fushat”, shtohet fusha 5 me këtë përmbajtje:

“5. Sigurim shoqëror për më shumë të ardhura”

2. Kapitulli III “Rregulla të veçanta”, ndryshon si vijon:

“1. Vazhdim vullnetar të sigurimit kanë të drejtë të bëjnë personat e interesuar, të cilët janë larguar nga sigurimi i detyrueshëm dhe nëpërmjet marrëveshjes për këtë fushë sigurimi, vazhdojnë sigurimin për të gjitha degët e sigurimit të detyrueshëm. Ata kanë të drejtë të paguajnë kontribute deri në nivelin maksimal, për përfitime deri në nivelin maksimal.

2. Zgjerim vullnetar të degëve të sigurimit kanë të drejtë të bëjnë të vetëpunësuarit dhe punëdhënësit, të cilët janë në sigurimin e detyrueshëm dhe kanë kontribuar për një vit rresht në këtë sigurim. Zgjerimi lejohet vetëm për degët e paafëtisë së përkohshme në punë, aksidentet në punë e sëmundjet profesionale. Përfitimet do të jepen sipas rregullave në fuqi për këto degë në sigurimin e detyrueshëm. Nuk lejohet sigurim për këto dy degë për të përfituar pagesa për periudhat e kaluara.

Kontributet dhe përfitimet për zgjerim vullnetar të degëve të sigurimit janë në nivele minimale.

3. Mbulim vullnetar të periudhave të kaluara kanë të drejtë të bëjnë personat e interesuar, të cilët paguajnë kontribute vullnetare për periudhat e kaluara dhe jo për vitin korent. Kontributi do të jetë në masën e kontributit minimal në kohën e pagesës së tyre, por do t'i korrespondojë pagës për efekt kontributi të vitit që po mbulohet me sigurim. Përfitimet në këtë fushë janë vetëm për pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar.

4. Sigurim vullnetar kanë të drejtë të bëjnë personat e interesuar, të cilët nuk janë ekonomikisht aktivë dhe sigurohen për vitin korent. Ata kanë të drejtë të paguajnë kontribute deri në nivelin maksimal, për të përfituar deri në nivelin maksimal të pensionit të pleqërisë, invaliditetit dhe atij familjar.

5. Sigurim, për një shumë më të madhe të ardhurash, kanë të drejtë të bëjnë të vetëpunësuarit, të punësuarit dhe punëdhënësit privatë duke paguar kontribute deri në nivelin maksimal, për të përfituar deri në nivelin maksimal të pensionit të pleqërisë, invaliditetit dhe atij familjar.”

3. Në kapitullin IV “Kontributet”, bëhen këto ndryshime:

- në pikën 2 “Pagesa e kontributeve”, shkronja (a), numrat 1, 2, dhe 3, ndryshohen si vijon:

“b) Kontributet tremujore do të zbriten me 1.5 %,

c) Kontributet gjashtëmujore do të zbriten me 3 %,

d) Kontributet vjetore do të zbriten me 6 %,

të kontributeve mujore totale të parapaguara respektivisht në periudhën 3, 6 dhe 12 mujore.

- në fund të kapitullit, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kontributet vullnetare, të paguara më tepër, do të transferohen për të mbuluar periudha të pasiguruara ose për përfitime deri në nivelin maksimal, dhe diferenca që mund të rezultojë do të kalojë në fondin rezervë të ISSH -së”.

4. Kapitulli V “Marrëveshja për sigurim vullnetar”, ndryshon si vijon:

Kësaj rregulloreje i bashkëngjiten e miratohen dy tipe marrëveshje për sigurim vullnetar.

Marrëveshja tip (1) lidhet midis personit të interesuar dhe ISSH-së. Personi i interesuar, nëpërmjet një deklarimi personal, autorizon një person të tretë për të nënshkruar marrëveshje për sigurim vullnetar dhe/ose për të paguar kontributet. Në deklarim shënohen edhe numri, data dhe vendi i lëshimit të pasaportës dhe shoqërohet me certifikatën personale me fotografi të personit të interesuar.

Marrëveshja tip (2) lidhet midis personit të interesuar dhe agjentit të sigurimit vullnetar jashtë territorit të Shqipërisë, të kontraktuar nga ISSH-ja. Personi i interesuar nëpërmjet një prokure të posaçme autorizon një person të tretë për të nënshkruar marrëveshje për sigurim vullnetar dhe/ose për të paguar kontributet.”

5. Në kapitullin VI “Agjenti i sigurimit vullnetar”, paragrafi i parë hiqet dhe zëvendësohet me paragrafët që vijojnë:

Kësaj rregulloreje i bashkëngjiten e miratohen dy tipe kontrate me agjentin e sigurimit vullnetar.

Kontrata tip (1) është kontrata e lidhur midis ISSH-së dhe agjentit të sigurimit vullnetar që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kontrata tip (2) është kontrata e lidhur midis ISSH-së dhe agjentit të sigurimit vullnetar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

6. Në kapitullin VII “Rregulla të fundit”, shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Për zbatimin e kësaj rregulloreje Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së nxjerr udhëzim.”

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Engjell Bejtaj**



**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
  - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".  
Tel: 042 555 63; 267 468

**Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën:**

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**BOTIMET:**

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR ( i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

**DOLI NGA SHTYPI**

**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004**

**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004**

Doli nga shtypi më 3.5.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë